VENDIM
Nr. 567, datë 25.8.2022

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 794, DATË 11.12.2019, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR "RRUGA E ARBRIT""

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 794, datë 11.12.2019, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në pikat 3 dhe 4, vlera "... 1 768 919 (një milion e shtatëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e nëntëqind e nëntëmbëdhjetë) lekësh zëvendësohet me vlerën "... 6 244 373 (gjashtë milionë e dyqind e dyzet e katër mijë e treqind e shtatëdhjetë e tre) lekë ...".

2. Pas pikës 4 shtohet pika 4.1, me këtë përmbajtje:

"4.1 Vlera shtesë e shpronësimit prej 4 475 454 (katër milionë e katërqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e katërqind e pesëdhjetë e katër) lekësh përballohet nga buxheti i Autoritetit Rrugor Shqiptar.".

3. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohen nga buxheti i Autoritetit Rrugor Shqiptar.

4. Tabelës bashkëlidhur vendimit në fuqi nr. 794, datë 11.12.2019, të Këshillit të Ministrave, i shtohet edhe tabela bashkëlidhur këtij vendimi.

II. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Tiranë, si dhe Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Dibër për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

LISTA EMËRORE PËRFUNDIMTARE E PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 794, DATË 11.12.2019, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR SHPRONËSIM, PËR INTERES PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZMI I PROJEKTIT 'NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR 'RRUGA E ARBRIT"'

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Zona kadastr.	Numri i pasurisë	Sip. totale m^2	Lloji i pasurisë	TOKË TRUALL			TOKË ARË			OBJEKT BANIMI			VLERA TOTALE (LEKË)	SHËNIME	ADRESA
								Sipërfaqja e shpr. (m^2)	Çmimi (lekë/m^2)	Vlera lekë	Sip. e shpr.	Çmimi (leke/m^2)	Vlera lekë	Sip, e shpronësuar	Çmimi (lekë/m^2)	Vlera lekë			
1	ALLAMAN	XHELADIN	MIFTARI	1372	13/1	2000	arë+truall +nd	200	110	22000	526	100	52600	98	27170	2662660	2,737,260.00	Konfirmuar nga ASHK-ja. Shpronësohet për objektin dhe truallin	ÇERENEC I POSHTËM
2	AMARILDO	HYSNI	DOKA	1644	482/3	6780	ARE				1588	114	181032				181,032.00	Konfirmuar nga ASHK-ja	KLOS
3	ARJOLA	BESIM	KUKA	3426	799/12	5400	Truall	974	490	477260							477,260.00	Konfirmuar nga ASHK-ja	TIRANË, LINZË
4	ARJOLA	BESIM	KUKA	3426	799/11	1800	Truall	908	490	444920							444,920.00	Konfirmuar nga ASHK-ja	TIRANË, LINZË
5	RAMAZAN		AHMETAJ	3876	307/7/2	400	ARE				137	448	61376				61,376.00	Konfirmuar nga ASHK-ja	TIRANË
6	RAMAZAN		AHMETAJ	3876	316/11/1	680	ARE				74	448	33152				33,152.00	Konfirmuar nga ASHK-ja	TIRANË
7	BAJRAM	ALI	BALLIU	3426	968/3	2130	ARE				1000	448	448000				448,000.00	Konfirmuar nga ASHK-ja	TIRANË
8	BAJRAM	SEFER	DALIPI	1644	445/1	2500	ARË				811	114	92454				92,454.00	Konfirmuar nga ASHK-ja	MAT FSHATI FSHAT
	Totali							**2082**		**944180**			**233632**	**98**		**2662660**	**4,475,454.00**		